




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Ref:1809/1032/BA/AH
Nr. 05/2018**

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Avdyl Hyseni, kryetar dhe Musa Dragusha e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën Nr. 1809/988/BA/nr të datës 07.09.2018 të parashtruesit International Maarif Schools of Kosova, e përfaqësuar nga avokat Delvina Nallbani nga Prishtina ndaj Vendimit Nr.2018/54 të datës 09.08.2018 të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), me datë 21.09.2018 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa nr. 1809/988/BA/nr e datës 07.09.2018 e International Maarif Schools of Kosova, nga Prishtina dhe mbetet në fuqi Vendimi nr.2018/54 i datës 09.08.2018 i Komisionit të Pavarur për Media.

A r s y e t i m

International Maarif Schools of Kosova, me date 07.09.2018 ka parashtruar ankesë kundër Vendimi nr. 2018/54 të datës 09.08.2018 të Komisionit të Pavarur për Media, pran Bordit për Ankesa.

Bardi për Ankesa, në seancën e mbajtur me date 21.09.2018, ka shqyrtuar ankesën nr. 1809/988/BA/nr të datës 07.09.2018 e International Maarif Schools of Kosova, e përfaqësuar nga avokat Delvina Nallbani nga Prishtina ndaj Vendimit Nr.2018/54 të datës 09.08.2018, të Komisionit të Pavarur për Media, ne të cilin konstaton se KTV ka vepruar në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, për kundër ankesës së International Maarif Schools of Kosova, e cila pretendon se KTV i ka dëmtuar reputacionin dhe imazhin e shkollës.

International Maarif Schools of Kosova, në ankesë konsideron se Vendimi nr. 2018/45 i datës 09.08.2018 i KPM-së, është i pabazuar duke pasur parasysh se kronika nuk përmban as një informacion rreth shkollës, funksionimit të saj apo planprogramit, përkundrazi raportimi me titullin Shkolla "Maarif" s'kontrollohet nga MASHT-i, disa mësuese janë të mbuluara përmban konstatim me të cilin krijohet imazhi i një shkolle e cila funksionon dhe zhvillon planprogramin e saj jashtë mbikëqytjes se MASHT-it.


Bordi për Ankesa, ka shqyrtuar ankesën e International Maarif Schools of Kosova, dhe ka analizuar të gjitha pretendimet dhe prova, andaj konstaton se Vendimi nr. 2018/45 i datës 09.08.2018 të Komisionit të Pavarur për Media, është i drejtë dhe i bazuar ne Ligjin Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe rregullativën e kësaj fushe.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në ne faktet e lartcekura, si dhe bazuar ne nenin 36 paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, vendosi unanimitisht si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi mund të iniciohet konflikt administrative me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.

Aydyl Hyseni

Kryetar i Bordit për Ankesa

